ALBANIAN

2019-2020 WELCOME BOOKLET for MULTILINGUAL FAMILIES and ENGLISH LEARNERS



MULTILINGUAL ASSESSMENT CENTER
440 N. BROAD STREET, SUITE 1058
PHILADELPHIA, PA 19130
PHONE: (215) 400-4240 (OPTION 1)

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

PARENT WELCOME BOOKLET

This book belongs to:

_____

Përmbajtja:

1. Letër Mirëseardhje
2. Kalendar
3. E drejta e Gjuhës
   a. Asistenti Këshillues Dygjuhësh
   b. Përkthime me Shkrim / Gojë
4.. Përmbledhje e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias
5. Mirëseardhja në Shkollë dhe Siguria
6 Të Drejtat e Përgjithëshme dhe Përgjegjësitë
   a. Edukimi i Detyrueshëm .
      i. Mungesat e Aprovuara
   b. Proçesi i Gjykatës së Mungesave në Drejtorieë Arsimore
   c. Ngacmimet dhe Sharjet
7. Të drejtat e nxënësve që mësojnë anglisht (Policy 138)
8. Regjistrimi,Caktimi i shkollave dhe Kërkesat për Diplomim
   a. Udhëzues Regjistrimi
   b. Caktimi i Shkollave
      i. Transporti
   c. McKinney-Vento / Akti ndihmës për edukimin e të pastrehëve
   d. Proçesi i Zgjedhjes së Shkollave
   e. Diplomimi nga shkollat e mesme
      i. Kërkesat
      ii. Transkripti i Huaj
      iii. Deklaratë Gjuhësore
   f. Proçesi i Identifikimit të nxënësit që mëson anglisht (EL)
9. Programi Gjuhësorë dhe nivelet e nxënësve që mësojnë anglisht
   a. ESL (Anglishtja si gjuhë e dytë)
      i. ESL Udhëzues për Prindërit
      ii. ESL Nivelet
      iii. Letër Refuzimi nga Prindëri
   b. Programi Dygjuhësh
   c. Akademia Mësimore për të Sapoardhurit
10. Burimet e Angazhimit të Familjes dhe Komunitetit
   a. Zyra e Angazhimit të Familjes dhe Komunitetit (FACE)
   b. Përmbledhje dhe Udhëzimet për Portalin e Prindërit
   c. Organizatat e Komuniteteve
11. Shtesë
   a. Kërkesat e krediteve të nevojëshme për Diplomim nga shkolla e mesme dhe pyetjet që bëhen më shpesh.
   b. Letër justifikimi për mungesat

1. Letër Mirëseardhje

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

Zyra e Kurrikulës dhe Programeve Shumëgjuhëshe
Zyra 251
440 North Broad Street
Filadelfia, PA 19130

Të dashur Prindër / Kujdestarë,

Në emër të Zyrës së Kurrikulës dhe Programeve Shumëgjuhëshe (OMCP), unë do të doja t'ju uroj mirëseardhjen në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias për vitin shkollor 2019-2020. Ne shikojmë përpara për një vit shkollor emocionues dhe produktiv.

Drejtoria Arsimore e Filadelfias përbëhet nga rreth 15,000 nxënës për të cilët anglishtja është gjuhë e dytë dhe në mënyrë kolektive përfaqësojnë më shumë se 130 vende dhe flasin më shumë se 100 gjuhë. Shumëllojshmëria është një pasuri e madhe për komunitetet tona shkollore dhe ne festojmë shumë kultura dhe gjuhë të përfaqësuara nëpër shkollat tona! Për më tepër, ne jemi të përkushtuar që të sigurojmë që të gjithë nxënësit , përfshirë ata me dokumenta, pa dokumenta, amerikanët e rinj dhe amerikanët e shumë -gjeneratave, të kenë të drejtën e një arsimi cilësor.

Kjo broshurë përfshin informacione dhe burime për t' ju ndihmuar për të kuptuar sistemin tonë shkollor dhe programet në shkolla për të mbështetur nxënësit që mësojnë gjuhën angleze. Unë ju inkurajoj që të komunikoni shpesh me mësuesit dhe drejtorët e fëmijëve tuaj dhe të kontaktoni kur keni pyetje. Prindërit dhe anëtarët e familjes janë partnerët tanë.

Ju uroj një vit të mbarë shkollor!

Sinqerisht,

Allison W. Still,
Deputy Chief

2. Kalendar

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

Kalendari Akademik 2019-2020

Ky kalendar përshkruan datat e rëndësishme të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, duke përfshirë edhe kur shkolla është e mbyllur. Mundet që kalendari të pësojë ndryshime gjatë rrjedhës së vitit shkollor ,prandaj ju lutemi gjithmonë të kontrolloni në: https://www.philasd.org/calendar/academic-calendar-sy-2019-2020/ për versionin më të fundit.

Data	Aktivitet
26 Gusht, 2019	Dita e parë për personelin shkollor
26 – 29 Gusht, 2019	Intervista Mësues / Prindër për Kopshtin
2, Shtator, 2019	Dita e Punëtorit – Shkollat dhe Zyrat Administratve Mbyllur
3 Shtator, 2019	Dita e parë e shkollës për K-12 – Pjesëmarrje e Nxënësve
3 Shtator, 2019	Dita e parë për " Head Start and Bright Futures" – Pjesëmarrje e Nxënësve
27 Shtator, 2019	Dite e Plotë për Kualifikim Profesional (vetëm për personelin) Shkolla Mbyllur për nxënësit)
30 Shtator, 2019	Rosh Hashanah – Shkollat dhe Zyrat Administrative Mbyllur

9 Tetor, 2019	Yom Kippur – Shkollat dhe Zyrat Administrative Mbyllur
16 Tetor, 2019	SAT/PSAT ditë shkolle
22 – 24 Tetor, 2019	Raporte të Ndërmjetëm

Data	**Aktivitet**
25 Tetor, 2019	Kualifikim Profesional Gjysëm Dite – dalje e hershme nga shkolla (3 orë)
5 Nentor, 2019	Dita e Votimeve – Shkolla Mbyllur
11 Nentor, 2019	Dita e Veteranëve – Shkollat dhe Zyrat Administrative Mbyllur
15, Nentor, 2019	Kualifikim Profesional Gjysëm Dite – Dalje e hershme nga shkolla (3 orë)
20 – 22 Nentor, 2019	Mbledhjet Mësues / Prindër për dëftesat
28 – 29 Nentor, 2019	Dita e Falenderimit – Shkollat dhe Zyrat Administrative Mbyllur
17 – 19 Dhjetor,2019	Raporte të Ndërmjetëm
23 Dhjetor, 2019	Ditë e Plotë për Kualifikim Profesional (vetëm për personelin) Shkolla Mbyllur për nxënësit

24 Dhjetor, 2019 – 1 Janar, 2020	Pushimet Dimërore – Shkolla Mbyllur
20 Janar, 2020	Dita e Dr. Martin Luther King Day – Shkollat dhe Zyrat Administrative Mbyllur
24 Janar, 2020	Kualifikim Profesional Gjysëm Dite – Dalje e hershme nga shkolla (3 orë)
5 – 7 Shkurt, 2020	Mbledhjet Mësues / Prindër për dëftesat
17 Shkurt, 2020	Dita e Presidentit – Shkollat dhe Zyrat Administrative Mbyllur
28 Shkurt, 2020	Kualifikim Profesional Gjysëm Dite – Dalje e hershme nga shkolla (3 orë)
10 – 12 Mars, 2020	Raporte të Ndërmjetëm

Data	Aktivitet
6 – 10 Prill, 2020	Pushimet Verore – Shkolla Mbyllur
15 – 17 Prill, 2020	Mbledhjet Mësues / Prindër për dëftesat
24 Prill, 2020	Kualifikim Profesional Gjysëm Dite – Dalje e hershme nga shkolla (3 orë)
28 Prill, 2020	Dita e Votimeve – Shkolla Mbyllur
13 – 15 Maj, 2020	Raporte të Ndërmjetëm

22 Maj, 2020	Kualifikim Profesional Gjysëm Dite – Dalje e hershme nga shkolla (3 orë)
25 Maj, 2020	Dita Përkujtimore
10 – 12 Qershor, 2020	Periudha e Diplomimit
12 Qershor, 2020	Dita e fundit për nxënësit

Përkufizimet e Kalendarit:

- **Dita e Punëtorit:** Pushime publike që nderojnë njerëzit që punojnë, e Hëna e parë e Shtatorit për Shtetet e Bashkuara dhe Kanada, në shumë vende të tjera më 1 Maj.
- **Rosh Hashanah:** Viti i Ri hebre.
- **Yom Kippur:** Agjërimi më solemn fetar i vitit për popullsinë hebre, dhjetë ditët e fundit që çuan në Rosh Hashanah (Viti i Ri hebre)
- **SAT / PSAT:** The Scholastic Aptitude Test (SAT) është një provim pranues i përdorur nga shumica e kolegjeve dhe universiteteve për të matur nivelin e nxënësit për kolegj. Praktika Scholastic Aptitude Test (PSAT) është një version praktik i SAT që përgatit nxënësit për provimin aktual.
- **Raportet e ndërmjetme:** Prindërit marrin raporte në mes të periudhës semestrale . Këto raporte të përkohshme ju japin një pasqyrë në lidhje me progresin e fëmijës suaj dhe ju njoftojnë se si po përparon fëmija juaj para se të marrin notat.
- **Dita e Zgjedhjeve:** Dita në të cilën bëhen zgjedhjet për zyrën publike lokale, shtetërore dhe kombëtare. Ditët e Zgjedhjeve ndryshojnë nga shteti. në shtet.
- **Dita e Veteranëve:** Një festë publike e Shteteve të Bashkuara të mbajtur në përvjetorin e Luftës së Parë Botërore për të nderuar veteranë dhe viktimat e të gjitha luftërave të Shteteve të Bashkuara.
- **Kualifikimi Profesional Gjysëm Dite:** Shkollat mbyllen gjysmën e ditës, kështu që Mësuesit mund të marrin pjesë në trajnime.
- **Konferencat mësues** - prindër për shpërndarjen e dëftesave të notave : Një takim midis prindërve dhe mësuesve për të diskutuar përparimin e fëmijëve të tyre në shkollë.
- **Festa e Falënderimeve**: Një festë e kremtuar në Shtetet e Bashkuara, Kanada, disa Ishujt Karaibe dhe Liberi, e cila filloi si një ditë falënderimi për bekimin e të korrave.
- **Pushime dimërore.**
- **Dr. Martin Luther King Jr. Day**: Një festë e kremtuar në Shtetet e Bashkuara për nder të ditëlindjes së Dr. Martin Luther King Jr. Dr. Martin Luther King Jr ishte një udhëheqës i të drejtave civile.
- **Dita e Presidentit:** Një festë e festuar në Shtetet e Bashkuara për nder të presidentëve.
- **Pushime pranverore.**
- **Dita Përkujtimore**: Një festë e kremtuar në Shtetet e Bashkuara për nder të atyre që vdiqën në shërbimin ushtarak aktiv.
- **Periudha e diplomimit:** Kjo është periudha kur shkollat mund të bëjnë diplomimet e tyre. Ato mund të bëhen në ditët e para të muajit Qershor.

3. Ndihma për gjuhën

Drejtoria Arsimore e Filadelfias angazhohet të sigurojë që nxënësit e emigrantëve, refugjatëve dhe familjet e tyre të kenë të drejta të barabartë në shërbimet dhe mundësitë arsimore dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë akademik dhe social.

Ne nderojmë kulturat dhe gjuhët e familjeve tona dhe sigurojmë që gjuha nuk është pengesë, por pjesë e trashëgimisë së pasur që sjellin nxënësit dhe familjet e tyre.

Faqet e mëposhtme ju japin një listë të plotë të shërbimeve që mbështesin nxënësit dhe familjet shumëgjuhëshe.

Bilingual Counseling Assistants (BCAs)

Asistentët Këshillues Dygjuhësh (BCAs) në mënyrë kolektive flasin mbi 50 gjuhë dhe dialekte; lehtësojnë komunikimin ndër-kulturor ndërmjet nxënësve, familjeve me anglishte të kufizuar dhe personelit të drejtorisë arsimore, duke ofruar shërbime të përkthimit me kompetencë kulturore relevante dhe gjuhësore; dhe organizojnë seminare mujore me prindërit në gjuhët e folura nga një segment i madh i popullatës sonë familjare.

Interpretim (i folur ose i shkruar):



Drejtoria Arsimore e Filadelfias ofron shërbime falas të interpretimit (përkthim me gojë) për të gjitha shkollat publike dhe zyrat e drejtorisë . Shërbimet ofrohen në person nga Asistenti Këshillues Dygjuhësh (BCAs), ose përmes telefonit në më shumë se 200 gjuhë. (Të gjitha shkollat kanë një llogari të personalizuar me" Language Line Solutions" për interpretimin telefonik.)

Shërbimet e interpretimit në person janë në dispozicion të familjeve tona në mjedise të tilla si ato të listuara më poshtë, por nuk kufizohen vetëm në sa vijon:

- Regjistrimi në shkolla
- Regjistrimi shkollor në Qendrën e Vlerësimit Shumëgjuhësh (MAC)
- Konferencat prindër / mësues për shpërndarjen e dëftesave shkollore
- Takime të veçanta lidhur me arsimin
- Vlerësime psikologjike
- Takime familjare dhe seminare
- Ngjarjet e mëdha organizuar nga drejtoria arsimore
- Takimet e Bordit të Shkollës
- Seanca disiplinore
- Seancat e dëbimit
- Takimet e Këshillit Konsultiv të Shkollës

Përkthimi (me shkrim)

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ofron shërbime përkthimi falas në të gjitha shkollat publike dhe në zyrat e Drejtorisë . Shërbimet e përkthimeve variojnë nga dokumentet që shkojnë të të gjitha familjet nga zyra qëndrore e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, në kalendarët dhe në dokumente të tjera specifike për shkollën, si dhe në përkthimin e të dhënave akademike për nxënësit e shkollave të mesme dhe të rekordeve të huaja mjekësore. Përkthimet plotësohen nga Asistenti Këshillues Dygjuhësh (BCAs) dhe Koordinatorët e Gjuhëve në Zyrën e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit (FACE). Dokumentet e drejtorisë dhe të shkollave përkthehen në tetë gjuhët më të zakonshme të Drejtorise : Shqip, Arabisht, Kamboxhiane (khmer), Kineze, Frëngjisht, Rusisht, Spanjisht dhe Vietnameze, si dhe gjuhë të tjera sipas kërkesës.

Faqet për gjuhët

Ekzistojnë tetë faqe gjuhësore të bazuara në websajtin që janë krijuar për të adresuar disa nga shqetësimet më të spikatura për familjet e imigrantëve dhe refugjatëve.



Faqet e internetit janë aktualisht në dispozicion në tetë gjuhët më të zakonshme të Drejtorisë: Shqip, Arabisht, Kamboxhiane (khmer), Kineze, Frëngjisht, Rusisht, Spanjisht dhe Vietnameze;

Faqet e gjuhës janë të ndara në pesë tema kryesore:

- Edukimi në Shtetet e Bashkuara
- Përfshirja në Edukimin e Fëmijës Suaj
- Burimet Familjare dhe Komunitare
- Shëndeti dhe Siguria
- Dokumentet e Rëndësishme

Këto tema janë ndarë në tema me më detaje në fushën e informacionit,burimeve dhe mundësive për familjet dhe nxënësit e tyre

Karta e Kërkesës për Gjuhë

Këto karta të madhësisë së portofolit japin udhëzime për personelin e drejtorisë ku të gjejnë një përkthyes. Ata gjithashtu i informojnë familjet për të drejtën për tu shërbyer në gjuhën e tyre. Familjet shumëgjuhësore mund të shkojnë në çdo shkollë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias ose në zyrë dhe të paraqesin një kartë kërkese për shërbimin e gjuhës (në dispozicion në 32 gjuhë). Shembulli më poshtë ilustron karakteristikat:

Attention School District Staff:
This parent speaks Albanian.
If you do not have access to
Albanian-speaking staff, please use
Pacific Interpreters Telephonic Service.
To obtain access code
please call 215-400-4180, Option.4.

Language Service Request Card
The School District of Philadelphia

Mbajeni këtë kartë për përdorim të mëtejshëm

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është e
përkushtuar t'ju siguroje shërbime gjuhësore
falas. Nëse ju keni nevojë për përkthyes,
ju lutemi paraqiteni këtë kartë tek përsoneli
i shkollës; udhëzimet se si të kryhet ky
shërbim janë dhënë në Anglisht në pjesën e
pasme të kartës.

Kartë Kërkese për Shërbim Gjuhësor

Linjat telefonike të gjuhëve

Ekzistojnë 18 linja telefonike të gjuhës në dispozicion të familjeve shumëgjuhëshe. Familjet mund të telefonojnë 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë për të lënë një mesazh me ndonjë pyetje apo shqetësim, dhe brenda 24 orëve (me përjashtim të fundjavës dhe të verës), një asistent këshillues dygjuhësorë do të përgjigjet. (Linja telefonike në gjuhën spanjishte është një linjë e drejtpërdrejtë.)

Linjat telefonike të gjuhëve

Shqip: 215-400-8480	Malajalam: 215-400-8495
Arabisht: 215-400-8481	Nepali: 215-400-8496
Bengali: 215-400-8476	Pashto: 215-400-8494
Burmeze: 215-400-8479	Portugalisht: 215-400-8474
Kineze: 215-400-8482	Rusisht: 215-400-8485
Frëngjisht: 215-400-8483	Ukrainase: 215-400-8473
Indoneze: 215-400-8492	Uzbek: 215-400 - 8478
Khmer: 215-400-8484	Vietnameze: 215-400-8487
Kurde: 215-400-8472	Uolof: 215-400-8488

Shërbime Ndihmëse Shtesë për Familjet Shumëgjuhëshe

Aktivitetet dhe Seminaret e Mirëseardhjes

Këto aktivitetet janë trajnime familjare dhe seminare që trajtojnë tema me interes të veçantë për familjet e imigrantëve / refugjatëve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Në të drejtën për shërbim gjuhësor
- Proçesi i zgjedhjes së shkollës
- Siguria në shkollë
- Parandalimi i Ngacmimeve / Sharjeve
- Gatishmëria për shkollë
- Të drejtat në Shëndetësi
- Të drejtat për të vazhduar Kolegjin.

Seminaret e Mirëseardhjes organizohen nga Asistentë Këshillues Dygjuhësh në shkolla dhe në organizata të bashkësisë dhe besimit dhe zakonisht ofrohen një herë në muaj në shkollat ku janë caktuar këta Asistentë dygjuhësorë.

Rrathët e Shkrim - Leximit

Rrathët e Shkrim - Leximit inkurajojnë familjet që të përdorin njohuritë e tyre gjuhësore dhe kulturore si një trampolinë për zhvillimin dhe kultivimin e shkrim-leximit, dashurinë për lexim dhe një interes të gjatë në mësim. Rrathët e Shkrim - Leximit organizohen nga Asistentët Këshillues Dygjuhësorë në shkolla.

*** Për më shumë informacion mbi aktivitetet, Seminaret e Mirëseardhjes dhe Rrathët e Shkrim - Leximit , kontaktoni një Asistent Këshillues Dygjuhësorë në shkollën tuaj.*

4. Përmbledhje e Drejtorisë Arsimore

Edukimi në Shtetin e Pensilvanisë

Edukimi publik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është falas për të gjithë nxënësit nga klasat e kopshtit deri në klasat e dymbëdhjeta (12), pavarësisht nga statusi i emigracionit ose origjina kombëtare. Shteti i Pensilvanisë ka ligje në lidhje me moshat që fëmijët duhet të shkojnë në shkollë. Ju lutem shihni më poshtë për këto ligje të shtetit.

Kopshti Parashkollor (Pre-K)
Fëmijët do të pranohen në programet e shërbimeve parashkollore të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias me kushtin që fëmija të ketë mbushur tre (3) vjeç përpara datës 1 Shtator.

Kopshti i fëmijëve (K)
Fëmijët do të pranohen në kopshtin e fëmijëve, me kusht që fëmija të ketë mbushur moshën pesë (5) vjeç më ose para 1 Shtatorit. Fëmija që ka mbushur moshën gjashtë (6) vjeçare me 1 Shtator, por nuk ka ndjekur një vit të plotë të kopshtit, me kërkesën me shkrim të prindit / kujdestarit, mund të marrin pjesë në kopshtin e fëmijëve në vend të klasës së parë, nëse ka vënde të lira..

Klasat e para (1) deri në të dymbëdhjeta (12).
Mosha e ndjekjes së shkollës në Pensilvani është 8-17 vjeç. Në Pensilvani, një fëmijë i cili mbush moshën 21 vjeçare gjatë afatit të shkollës dhe që nuk ka mbaruar Shkollën e Mesme (9 - 12), mund të vazhdojë të ndjekë falas shkollat publike që përfshihen në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias deri në fund të afatit të shkollës.

Shkollat në Drejtorine Arsimore të Filadelfias



Drejtoria Arsimore e Filadelfias përbëhet nga tre lloje të shkollave kryesore: shkollat fillore (k - 5), shkollat e mesme (6 - 8), dhe shkollat e mesme nga klasa e 9 - 12 (high school). Nxënësit u caktohen klasat në bazë të datës së lindjes së tyre për shkollën fillore dhe të mesme. Nxënësit që janë 14 vjeç e lart vendosen në (high school) 9 -12 duke u bazuar në numrin i kredive të fituara.

Grafiku më poshtë jep një pasqyrë të çdo lloji të shkollës (fillore, të mesme, dhe high school. (9 - 12).

Si është organizuar Shkolla tipike e SH.BA-së

Shkolla	Klasa	Mosha
Shkolla Fillore	Kopshti i fëmijëve dhe klasat 1 deri në 5 ose 1 deri në 6	Fëmijë të moshave 5 deri në 11 vjeç
Shkolla e mesme	Klasat nga 6 deri në 8, 7 deri në 8 ose 7 deri 9	Të rinj të moshës 11 deri 14 vjeç
Shkollat 9 - 12 (high School)	Klasat nga 9 deri 12 ose 10 deri 12	Të rinjtë 14-18 vjeç (dhe deri në 21 në disa raste)

Shënim: *Ka edhe disa shkolla që kombinojnë me shkollë fillore dhe të mesme, të cilat quhen shkolla "Kopshti deri në klasën e tetë".*

Shënim: *Ka disa (High School) në Drejtorinë Arsimore që gjithashtu përfshijnë klasat nga 6-12.*

Njerëzit në shkolla

- Drejtori është drejtuesi i shkollës. Drejtori është përgjegjës për funksionimin e përgjithshëm të shkollës. Ai ose ajo është "shefi".
- Ndihmës Drejtori ndihmon Drejtorin dhe është i dyti në krye të shkollës.
- Mësuesit janë njerëz të rëndësishëm për t'u njohur. Këta janë njerëzit që mësojnë drejtpërdrejtë fëmijën tuaj çdo ditë. Pritet që mësuesi dhe prindi të komunikojnë hapur. Mos hezitoni të vizitoni shkollën e fëmijës suaj ose kontaktoni mësuesin për të adresuar çdo pyetje që mund të keni. Nëse jeni i shqetësuar për progresin akademik të fëmijës suaj ose pyesni nëse fëmija juaj ka nevoja të veçanta, sigurohuni që të flisni me mësuesin e fëmijës tuaj për të ndarë këto shqetësime.
- Sekretari i shkollës është dikush që do të njihni dhe do të takoni kur hyni në zyrën kryesore. Ai ose ajo kujdeset për detajet administrative, cakton takimet dhe trajton komunikimin shkollor. Sekretari i shkollës është i vetëdijshëm për atë që po ndodh në shkollë në baza ditore.
- Asistentëve Këshillues Dygjuhësh (BCA) u caktohen shkolla të ndryshme në të gjithë Drejtorinë Arsimore të Filadelfias . Megjithëse ai ose ajo nuk është këshilltar i shkollës, BCA shërben si një urë gjuhësore dhe kulturore midis nxënësve , familjeve dhe shkollës.

- Infermierja e shkollës është dikush, qëllimi kryesor i të cilit është t'i mbajë nxënësit të shëndetshëm dhe të sigurtë në mënyrë që ata të jenë të gatshëm të mësojnë.
- Përgjegjësia primare e Policit të Shkollës është të ruajë rendin dhe sigurinë në baza shkollore dhe të sigurojë një mjedis pozitiv të të mësuarit.
- Shkollat gjithashtu kanë personel shtesë që punojnë në kafeterinë dhe pastrojnë shkollën.

5. Shkolla të Sigurta dhe me Mirëpritje

Drejtoria Arsimore e Filadelfias angazhohet të mbrojë të drejtat e të gjithë nxënësve pavarësisht nga raca, kombësia, feja, statusi i emigracionit, orientimi seksual ose gjinia.

Komuniteti i Emigrantëve

Drejtoria Arsimore e Filadelfias angazhohet të mbrojë të drejtat e të gjithë nxënësve me dokumenta, pa dokumenta, amerikanë të rinj dhe amerikanë me shumë breza. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për një edukim publik, pavarësisht nga statusi i emigracionit të tyre ose i prindërve të tyre. Prioriteti ynë është të sigurojmë që të gjithë nxënësit dhe familjet të ndihen të sigurta dhe të mirëpritura. Drejtoria Arsimore ka siguruar mjetet dhe njohuritë e nevojshme për administratorët, mësuesit dhe personelin për të mbrojtur sigurinë dhe të drejtat e nxënësve të familjeve të imigrantëve dhe të refugjatëve. Një nga këto mjete është pakoja me materialet e plota e Drejtorisë , e projektuar posaçërisht për personelin e shkollës. Për të marrë një kopje të këtij materiali , ju lutemi vizitoni https://www.philasd.org/face ose kërkoni një kopje përmes emailit në ask@philasd.org.

Drejtoria Arsimore e Filadelfias gjithashtu siguron ndihmë shtesë për komunitetin e emigrantëve nëpërmjet Asistentëve Këshillues Dygjuhësh (BCAs), të cilët punojnë në shumë shkolla të qytetit. Zyra e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit (FACE) gjithashtu siguron të drejtat në interpretimin e drejtpërdrejtë në mbledhjet me prindërit, konferencat, ngjarjet e drejtorisë dhe shkollës, krijon partneritete me organizatat e refugjatëve dhe mbështet familjet përmes seminareve të Mirëseardhjes.

Për më shumë informacion, ju lutemi telefononi Zyrën e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit (FACE) në (215) 400-4180.

Komuniteti Musliman

Drejtoria Arsimore e Filadelfias përqafon plotësisht shumëllojshmërinë. Ne fuqimisht promovojmë lirinë fetare për të siguruar që nxënësit dhe familjet e të gjitha besimeve të ndihen të sigurt dhe të mirëpritur. Rregullat e Edukimit Multiracial-Multikulturor-Gjinor u krijuan "për të nxitur njohuri dhe respekt për ato të të gjitha racave, grupeve etnike, klasave sociale, gjinive, feve, aftësive të kufizuara, orientimeve seksuale (të përceptuara ose të njohura) dhe identiteteve gjinore (të përceptuara ose të njohura) . "Zyra e Familjes

dhe Angazhimi i Komunitetit" angazhohet me familjet për të krijuar dhe mbajtur një mjedis të sigurtë dhe mikpritës për të gjitha komunitetet.

Shqyrto FAQ-in këtu: https://webapps1.philasd.org/downloads/tdm/FAQ_Post_Election.pdfpër të mësuar më shumë rreth organizatave dhe burimeve për komunitetin mysliman për të kundërshtuar urrejtjen, diskriminimin dhe për mbrojtjen e shumëllojshmërisë fetare.

Komuniteti Transgjinor

Politikat aktuale të Drejtorisë Arsimore përforcojnë lirinë e zgjedhjes për nxënësit transgjinorë, duke përfshirë të drejtat për të gjithë nxënësit që të përdorin banjën sipas zgjedhjes së tyre , t'u flitet në përemrat e tyre të preferuar dhe të bashkohen me ekipet atletike në bazë të zgjedhjes së tyre. William Hite thotë: "Është me të vërtetë e rëndësishme për ne që të sigurohemi që të gjithë të rinjtë tanë janë të sigurtë dhe të respektohen, pavarësisht nga identiteti i tyre gjinor , ne do të sigurohemi që ata të kenë cfarë u duhet për edukim. " Politika anti-diskriminuese e Drejtorisë Arsimore ofron njohuri dhe udhëzime në lidhje me trajtimin e nxënësve transgjinorë dhe jo-konformë. Ju lutemi lexoni rregulloren tonë këtu: https://www.philasd.org/schoolboard/wp-content/uploads/sites/884/2017/06/103_Nondiscrimination-in-School_Policy_Aug-1.pdf për të mësuar më shumë.

6. Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Përgjithshme

Edukimi i Detyrueshëm

Nxënësit në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias janë të detyruar me ligj që të shkojnë në shkollë çdo ditë. Kjo quhet "arsim i detyrueshëm" . Në mënyrë të veçantë, nxënësit që janë midis moshave 6 dhe 16 vjeç duhet të jenë në shkollë çdo ditë. Prandaj, është e rëndësishme që ju të siguroni që fëmija juaj shkon në shkollë çdo ditë. Kur fëmija juaj nuk është në gjendje të shkojë në shkollë, duhet të ndiqni udhëzimet e mëposhtme:

Mungesat

Ekzistojnë dy lloje të mungesave: **me arsye** dhe **pa arsye**.

- **Mungesat e justifikuara** përfshijnë sëmundje ose plagosje, mungesa në raste vdekje / varrimit dhe festat fetare. Një shënim me shkrim nga një prind ose kujdestar duhet të dorëzohet në shkollë menjëherë pas kthimit të nxënësit në shkollë. Shikoni seksionin e " Additional Resources" për shënimet në lidhje me mungesat që mund t'i përdorni për fëmijën tuaj. Mungesat e zgjatura (3 ose më shumë ditë) kërkojnë një shënim të mjekut.

- Nxënësit që kanë **mungesa për shkaqe** jo të sipërpërmëndura konsiderohen të paarsyeshme kur nuk shoqërohen me shënim për sqarim dhe Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka një proçes disiplinor strikt për nxënës të tillë.

Ngacmimi

Drejtoria Arsimore e Filadelfias i merr ngacmimet dhe sharjet shumë seriozisht. Më poshtë janë pyetjet e zakonshme që prindërit kanë:

Çfarë është sjellja brutale? Çdo konflikt nuk është ngacmim. Ngacmimi është një sjellje e rëndë, e përhapur, ose e vazhdueshme që ndikon negativisht në edukimin e nxënësit ose mjedisin shkollor. Ngacmuesi është një person që vazhdimisht keqpërdor fuqinë e tij kundër një personi tjetër.

Çfarë është ngacmimi? Ngacmimi është sjellje e padëshirueshme me fjalë, e shkruar, grafike ose fizike që lidhet me gjininë, moshën, racën, ngjyrën, orientimin seksual, identitetin gjinor, origjinën kombëtare, fenë, aftësinë e kufizuar, aftësinë e gjuhës angleze, statusin socio-ekonomik ose bindjet politike.

Çfarë duhet të bëjnë prindërit / kujdestarët? Tregojuni fëmijëve tuaj se ngacmimi dhe sharjet janë të ndaluara. Është e gabuar, ata nuk duhet ta bëjnë këtë, dhe nëse ndodh me ta, ata duhet t'ju tregojnë juve dhe mësuesve të tyre. Shembujt janë mënyra më e mirë për t'u treguar fëmijëve se çfarë nënkuptojmë. Për shembull, tallja ose kërcënimi për të lënduar dikë për shkak të racës, gjuhës së tyre amtare ose orientimit seksual nuk është gjë e rregullt- është ngacmimi! Kërcënimi i dikujt nëpërmjet internetit është ngacmim nëpërmjet internetit !

Nëse dyshoni se fëmija juaj është duke u ngacmuar ose kërcënuar, duhet: Raportoni situatën tek mësuesi i fëmijës suaj ose administratori shkollës. Pyetni fëmijën tuaj: kush është i përfshirë, çfarë kanë bërë, kur dhe ku ndodhi. Plotësoni Formularin e Raportimit dhe Hetimit të Dhunimit dhe Ngacmimit të Drejtorisë Arsimore (në dispozicion në shkollë dhe në faqen e internetit të Drejtorisë Arsimore : https://www.philasd.org/bullying/programs-and-

services/reporting-bullying-and-harassment/) dhe dorëzojeni tek mësuesi ose drejtori. Nëse keni nevojë për shërbime përkthimi për të bërë raportin, kërkoni nga shkolla. Nëse nuk merrni përgjigje, telefononi në linjën telefonike për ngacmimet : (215) 400-SAFE.

Ofroni strategjitë pozitive për fëmijën tuaj, të tilla si pyetje mësuesit për ndihmë, kërkoni një takim me një këshilltar, dhe fëmija të mundohet të shmangë personin që e ngacmon.

Çfarë nuk duhet të funksionojë? Inkurajimi i fëmijës tuaj për të luftuar përsëri. Inkurajimi i fëmijës tuaj të afrohet me fëmijën që është ngacmues.

Çfarë duhet të presësh? Shkolla duhet të kryejë një hetim për të zbuluar nëse konflikti është ngacmim, sharje ose ndonjë sjellje tjetër që duhet adresuar. Duhet të informoheni për rezultatin e hetimit dhe çfarë hapash te tjera do të ndërmarrë shkolla . Megjithatë, ligjet federale të privatësisë ndalojnë shkëmbimin e informacionit që lidhet me disiplinën ose ndërhyrjet e një nxënësi tjetër.

Pyetjet? Bisedoni me mësuesin dhe drejtorin e fëmijës suaj. Merrni pjesë në mbledhjet e prindërve gjatë gjithë vitit për të diskutuar këto çështje. Telefononi në linjën telefonike të ngacmimit dhe sjelljes brutale të Drejtorisë Arsimore në : (215) 400-SAFE.

7. Të drejtat e nxënësve, për të cilët anglishtja është gjuhë e dytë (Rregullore 138)

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka përcaktuar rregullat zyrtare për të siguruar që nxënësit që mësojnë gjuhën angleze t'u ofrohet një edukim cilësor. Kjo Rregullore është titulluar "Rregullore 138: Zhvillimi i gjuhës Angleze / Programi i Edukimit Dygjuhësor". Rregullorja përshkruan kërkesat dhe detyrimet e mësuesve, drejtorëve dhe personelit të drejtorisë nëpër shkolla në lidhje me edukimin e nxënësve që mësojnë gjuhën angleze. Kjo përcakton kërkesat specifike në fushat e mëposhtme:

- Identifikimi, Vendosja dhe Njoftimet
- Programet Mësimore
- Të drejta të Barabarta
- Vlerësimi dhe Përgjegjshmëria
- Angazhimi i Prindit, Familjes dhe Komunitetit

Këtu është një lidhje me dokumentin e plotë të Rregullores 138: https://www.philasd.org/schoolboard/wp-content/uploads/sites/884/2018/01/Policy-138.pdf.

8. Regjistrimi, Caktimi i Shkollës dhe Kërkesat e Diplomimit

Udhëzimet e regjistrimit

Për t'u regjistruar në një shkollë të Drejtorisë, të gjithë nxënësit duhet të kenë dëshmi të moshës së fëmijës, të dhënat e tyre të vaksinimit dhe dy dokumenta të adresës së tyre në emrin e prindit ose në emrin e kujdestarit ligjor. Si pjesë e përpjekjeve të Drejtorise për të ruajtur një mjedis të sigurt për nxënësit, shkollat mund të kërkojnë një kopje të identifikimit me fotografinë e prindit / kujdestarit në kohën e regjistrimit.

NUK duhen kërkuar gjatë regjistrimit:

- Numri i Social Security
- Pasaportë, vizë ose dëshmi për statusin e emigracionit të fëmijës ose të prindërve
- Rekordi i Agjencisë së Zhvendosjes

Detyrat dhe Transporti i Shkollës

Nxënësit u caktohen shkollat bazuar në adresën e tyre të shtëpisë. Varësisht se sa larg jeton fëmija nga shkolla, mund t'u sigurohet transporti. Rregullat e përshtatshmërisë së transportit të Drejtorisë janë përshkruar më poshtë:

- Transporti me autobus me ngyrë të verdhë zakonisht ofrohet për nxënësit e klasave 1 deri në 6 që jetojnë **1.5 milje** ose më shumë nga shkolla e caktuar
- Nxënësit e klasave 7 deri në 12 që jetojnë 1.5 milje ose më larg nga shkolla, kanë të drejtë për Falas " TransPasses Student "për transportin publik SEPTA (autobus, metro, etj)
    - Nxënësit që janë refugjatë kanë të drejtën e transportit nëse jetojnë 1milje ose më larg nga shkolla

McKinney-Vento (Akti i Asistencës për Arsimin e Pastrehë McKinney-Vento)
Ekzistojnë mbrojtje të posaçme për nxënësit që janë të pastrehë. Këto mbrojtje vijnë nga Akti i Asistencës për Arsimin e Pastrehë McKinney-Vento. Ky akt siguron ndihmë urgjente për të mbrojtur dhe përmirësuar jetën dhe sigurinë e të pastrehëve, me theks të veçantë tek personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me fëmijë.
Për sa i përket regjistrimit në shkollë, fëmijët e pastrehë kanë të drejtën për një arsimim publik falas. Pikat e mëposhtme janë informacion i rëndësishëm për të ditur:

- Sipas Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë (PDE), nxënësit , vendbanimi kryesor i të ilëve nuk janë "të fiksuar, të rregullt dhe adekuat" kualifikohen për trajtim të posaçëm kur regjistrohen në shkollë në mënyrë që të marrin ndihmë dhe shërbime të përshtatshme arsimore.
- PDE i konsideron individët e mëposhtëm si të pastrehë:
  - Fëmijët ose të rinjtë dhe familjet e tyre që jetojnë në një strehimore, strehim të përkohshëm, motel, automjet, kamp strehimi, në rrugë ose u shtohen të afërmve ose miqve për shkak të mungesës së banesave konsiderohen të pastrehë.
- Nxënësit që jetojnë në një strehim emergjent ose në strehim të përkohshëm, të rinjtë e pashoqëruar,të rinjtë refugjatë dhe emigrantë ndër të tjera kanë të drejtën e regjistrimit të menjëhershëm dhe të mëngjezit dhe drekës falas.
- Shkollat duhet të ndihmojnë të rinjtë e pastrehë me çdo dokument të regjistrimit të nevojshëm, me shërbim transporti dhe me sigurimin e uniformës dhe materialeve shkollore .
- Kualifikohen për McKinney-Vento nxënësit që përjetojnë mungesën e strehimit (nxënësit që jetojnë në një strehim emergjent ose strehim të përkohshëm, të rinj të pashoqëruar, refugjatë, migrantë, etj.), të cilët jetojnë **të paktën një milje** larg shkollës, kanë të drejtë të marrin ndihmë për transport.

Proçesi i Përzgjedhjes së Shkollave

Proçesi i zgjedhjes së shkollës është për nxënësit dhe familjet që dëshirojnë të aplikojnë në një shkollë jashtë kufijve të tyre të lagjes **për vitin e ardhshëm shkollor**. Aplikimet pranohen në **internet** zakonisht nga fundi i Shtatorit deri në fillim të Nëntorit të vitit shkollor aktual. Nëse jeni të interesuar të aplikoni në një shkollë jashtë kufijve tuaj të lagjes, ju lutemi kontaktoni këshilltarin ose drejtorin tuaj të shkollës.

Kërkesat e diplomimit të shkollës së mesme

Nxënësi i klasës së 12-të do të diplomohet nëse ai / ajo:

- Fiton një total prej 23.5 kredi, të cilat përfshijnë:
  - **4** kredi në **Anglisht**
  - **3** kredi në **Shkencë**
  - **3** kredi në **Studimet Sociale**
  - **1** kredi në **Historinë Afrikane /Amerikane**
  - **3** kredi në **Matematikë**
  - **2** kredi në **Gjuhë të Huaj**
  - **2** kredi në **Arte dhe Humanizëm**
  - **1** kredi në **Edukimin Fizik (P.E.)**
  - **0.5** kredi në **Edukimin Shëndetësor**

- **4** kredi në **Lëndët me zgjedhje**
  - Një lëndë me zgjedhje duhet të jetë një Matematikë përgatitore ose kurs shkencor, një kurs IB, një kurs AP, ose një kurs terminal CTE.

● Përfundon me sukses një Projekt Multidisiplinar ose një Projekt Mësimor

Totali i kredive të nevojshme për të diplomuar: 23.5 kredi

Kreditet duhet të jenë në secilën klasë:

(Një kredi është një vit i një lënde)

● **5** kredi të jesh në **klasën e 10 - të**

● **11** kredi të jesh në **klasën e 11-të**

● **17.5** kredi të jesh në **klasën e 12-të**

Shënim: Më shumë informacion është përfshirë në Shtojcën.

Transkriptet e huaja dhe deklarata për gjuhën

Transkriptet

● Transferimi i nxënësve nga jashtë Shteteve të Bashkuara do të kenë transkriptet e tyre të vlerësuara dhe përpunuara nga Qendra e Vlerësimit Shumëgjuhëshe (MAC).

● Jo më shumë se tetë kredi do të jepen për një vit shkollor, duke përfshirë:
- **Një** kredi në matematikë
- **Një** kredi në shkenca
- **Një** kredi në anglisht
- **Një** kredi për shkenca shoqerore
- Deri në **katër** kredi shtesë siç përshkruhet në transkript

● Kredia e gjuhës do t'u jepet nxënësve që plotësojnë **të gjitha** kriteret e mëposhtme:
- Regjistrimi fillestar nga një vend tjetër në klasën e dhjetë ose më lart
- Të përfundojë një vit të plotë të shkollës së mesme në të cilën gjuha e mësimit nuk është anglisht
- Dorëzoni transkriptat zyrtare nga shkolla e mesme duke treguar kurse, dhe afate të frekuentimit Në varësi të kursit, nxënësit do të marrin dy ose katër kredi në gjuhë të huaj

Nxënësi nuk do të marrë më shumë se **tetë** kredi për një vit të vetëm akademik.

Shënim: Transkriptet për nxënësit e huaj që shkëmbejnë eksperiencë nuk do të përpunohen. Çdo kredi që fiton një nxënës i tillë, ndërsa ndjek një shkollë të mesme të Drejtorisë së Filadelfias, do të dërgohet në shkollën nga ka ardhur(shtet tjetër) me të dhëna të tjera të nxënësit. Këta nxënës nuk kanë të drejtë për një Diplomë të Drejtorise Arsimore të Filadelfias.

Deklarata gjuhësore

Deklarimi i gjuhës i përjashton nxënësit nga kërkesat për të pasur një gjuhë të huaj në kërkesat e diplomimit , por nuk ul sasinë e kredive të kërkuara për diplomim.

Nxënësit që plotësojnë kriteret e mëposhtme kanë të drejtë për përjashtim në kreditin e gjuhës së huaj:

- Regjistrimi fillestar nga një vend tjetër në klasën e 7-të ose më lart
- Gjashtë vjet të arsimit paraprak në një gjuhë tjetër përveç anglishtes
- Kualifikohet për shërbimet EL në fillim të klasës së 9-të

Proçesi i identifikimit të nxënësve për të cilët anglishtja është gjuha e dytë

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka një proçes specifik për identifikimin e nxënësve që mësojnë anglishten si gjuhë të dytë (ELs). Nxënësit që regjistrohen për herë të parë në një shkollë të drejtorisë arsimore do t'i jepet një Anketë për Gjuhën (HLS) për ta plotësuar së bashku me Formularin e Regjistrimit të Nxënësit (EH-40) të cilat i jep sekretari /sekretarja e shkollës së lagjes. Bazuar në anketën gjuhësore, nxënësit shqyrtohen për tu përcaktuar nëse u nevojiten shërbime gjuhësore.Nxenësit që kualifikohen do të marrin udhëzime për t'i ndihmuar ata në mësimin e gjuhës angleze deri sa të arrijnë aftësitë e duhura në këtë gjuhë .Ndihmat e ndryshme janë të detajuar në pjesën tjetër.

9. Programet e Gjuhës dhe Nivelet e Gjuhës Angleze

Të gjithë nxënësit për të cilët anglishtja është gjuhë e dytë marrin programe mbështetëse për të ndihmuar zhvillimin e tyre në gjuhën angleze. Janë tre programe për nxënësit që mësojnë anglisht: Anglishtja si Gjuhë e Dytë, Programet Dygjuhëshe dhe Akademia Mësimore e të Porsaardhurve.



<u>Të drejtat e nxënësve që mësojnë gjuhën angleze:</u>

1. **E drejta për të ndjekur shkollën:** Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për shkollim publik falas deri në moshën 21 vjeç, pavarësisht aftësisë së tyre në gjuhën angleze.
2. **E drejta që të mos shahen dhe ushtrohen sjellje brutale mbi ta**.Nxënësit nuk mund të diskriminohen në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare ose fesë. Shkollat duhet t'i përgjigjen në mënyrë të përshtatshme ngacmimit të nxënësve EL, përndryshe do të shkelin një ose më shumë ligje të të drejtave civile.
3. **Të kenë të drejta të barabarta:** nxënësit EL duhet të kenë të drejta në të gjitha shërbimet që u ofrohen nxënësve të tjerë.
4. **E drejta për të mësuar gjuhën angleze:** nxënësit EL duhet të testohen për të përcaktuar aftësinë e tyre dhe të vendosen në nivelin e përshtatshëm të programit anglishtja si gjuhë e dytë (ESL) të mësohen nga një mësues i kualifikuar ESL / dygjuhësh.
5. **Të Drejtat e Familjeve të Nxënësve që Mësojnë Gjuhën Angleze:** Shkollat duhet të komunikojnë me prindërit me aftësi të kufizuar në gjuhën angleze, në gjuhën e tyre të preferuar dhe duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e prindërve duke ofruar shërbime përkthimi (p.sh., konferencat mësues prindër, mbledhjet e IEP dhe seancat disiplinore). Shkollat nuk mund t'u kërkojnë familjeve të ofrojnë përkthyesin e tyre ose ta përdorin fëmijën e tyre në këtë rol.

Nga Qendra Juridike e Arsimit: https://www.elc-pa.org/resource/rights-ofenglish-language-learners-families-with-limited-english-proficiency/

- *Drejtoria Arsimore e Filadelfisë flet mbi 100 gjuhë*
- *Drejtoria Arsimore e Filadelfias përfaqëson mbi 130 vende*

<u>Programi ESL</u>

